

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, - Departamenti i Krimeve te Renda, kryetari i trupit gjykues- gjyqtari Burim Ademi dhe anëtarët - gjyqtarët Florie Sylja dhe Kamer Caka me procesmbajtësen Xhemile Babatinci, ne lenden penale ndaj te akuzuarit B. R., për shkak te veprës penale Keqpërdorimi i te drejtës se votimit nga neni 216 par.1 nen par.1.2 te KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës te Prokurorisë Themelore ne Mitrovice- PP.I.nr.101/2014 te datës 15.07.2015, pas mbajtjes se shqyrtimit gjyqësor te dt.16.01.2017, ne mungese te prokurorit Njazi Rexha, e ne prani te pandehurit B. R., ne te njëjtën dite ka shpallur publikisht, ndërsa me dt. 27.01.2017 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: B. R., i, nga i ati S., e ëma H., i lindur me ne Mitrovice, ku edhe jeton rruga " " te , nr. letërnjoftimit , shqiptar, shtatës i Republikës se Kosovës, i pa pune, ka te kryer shkollën e mesme, i gjendjes se mesme ekonomike, me pare i pa gjykuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedure tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me dt. 03.11.2013 ne shkollën e mesme te mjekësisë ne komunën e Mitrovicës se veriut ne vendvotimin nr. 3806B/02D ka votuar si votues me kusht, edhe pse me pare ka votuar si votues i rregullt ne shkollën e fsh. Suhodoll.


- Me këtë ka kryer veprën penale Keqpërdorim i te drejtës se votimit nga neni 216 par. 1 pika 1.2 te KPRK-ës,

Andaj gjykata ne mbështetje te nenit 7,8,9,10,21,49,51,52,73, dhe 216 te KPRK-ës, dhe 248 e 326 e lidhur me nenin 365, 450 dhe 463 te KPP-ës e:

G J Y K O N

ME DENIM BURGU NE KOHEZGJATJEJE PREJ 8 (tetë) muaj, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale ne kohëzgjatjeje prej 1 (një) vit e 6 (gjashte) muaj.

I pandehuri obligohet qe te paguaj ne emër te paushallit gjyqësor shpenzimet ne lartësi prej 20 Euro pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit ndërsa shpenzimet tjera për shpenzimet tjera gjykata do te vendos.



Kërkesë pasurore juridike nuk kishte.

A r s y e t i m


Prokuroria Themelore ne Mitrovicë - ka ngritur aktakuze PP.I.nr.101/2014 te datës 15.07.2015 kundër te pandehurit B . R , për shkak te veprës penale keqpërdorim i drejtës se votimit nga neni 216 par 1 nen par 1.2 te KPRK-ës.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor ashtu qe ne këtë seance i pandehuri lidhur me fajësinë ka deklaruar: unë e ndijë veten fajtorë për veprën penale qe me vihet ne barre si dhe ne fjalën përfundimtare i pandehuri i propozon gjykatës qe te ia shqiptojë një dënim me te bute, jam penduar për veprimet e mia dhe nuk do te përsëris veprime te tilla.

Prokurori lidhur me pranimin e fajësisë dhe ne fjalën përfundimtare deklaroi: me qe i pandehuri e pranon fajësinë e pranimi i fajësisë behet ne mënyrë vullnetare pa presion e mbështetur ne provat te cilat gjenden ne shkresat e lendes i propozon gjykatës qe ta pranon fajësinë. Ndërsa ne fjalën përfundimtare thekson se nuk është kontestuese se i pandehuri e ka kryer veprën penale për te cilën ngarkohet ne aktakuze. Andaj i propozoj gjykatës qe te pandehurin ta shpall fajtor e me rastin e caktimit te llojit dhe lartësia se dënimit ti ketë parasysh rrethanat lehtësues dhe renduese parapara me ligj.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte ne përputhje me neni 248 pasi qe i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bene ne mënyrë vullnetare se aktakuza nuk përmban shkelje te qarte ligjore apo gabime faktike qe do te bënin te pamundur qe gjykata te beje vlerësimin e pranimi te fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban akuza, e qe konkretisht i pandehuri i njëjti kishte votuar si votues me kusht e pastaj ka votuar si votues me kusht, për veç se i pandehuri i pohon këto fakte te çështjes njëkohësisht këto fakte vërtetohen edhe me provat qe mbështesin akuzën e qe konkretisht nga kopja e zarfit te fletëvotimeve me kusht ne emër te te pandehurit, listën e votuesve me kusht, listën e votuesve te rregullt, lista(prova) me te dhënat e votuesve me kusht (te cilëve iu është refuzuar vota me kusht) qe përmbana te dhënat e vendvotimeve e nen numrin rendor 0073 është i pandehuri B R . Nga kjo rezulton se i pandehuri B R ka shfrytëzuar listën e votuesve me kusht ne vendvotimin nr.3806B/02D, qe po ashtu është nënshkruare edhe lista e votuesve nga i pandehuri, ndërsa po ashtu ne vendvotimin ne shkollën e fsh. Suhodoll me nr.3801B/02D i pandehuri ka shfrytëzuar listën e votimit dhe ka votuar si votues i rregullt, te gjitha këto për gjykatën për veç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë me përputhjen e pranimi te fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo vepër penale është e dënueshme me dënim me burgim nga 6 muaj deri ne 3 vite, andaj duke




vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese, kjo gjykate si rrethana renduese ka gjetur shkallen e përgjegjesisë penale gjë që nga provat rezulton se i pandehuri këtë vepër e kishte kryer me dashje drektë e që dashja direkte është shkalla më e lartë e përgjegjesisë penale, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e që kjo vepër penale ka qëllim të mbrojtë procesin zgjedhore që konsiston në një sistem demokratik, me qëllim që ky sistem të jete sa më legjitim nga deklarimi me votë i qytetarëve për përfaqësuesit e tyre, rrethanat me të cilat është kryer vepra po ashtu gjykata e ka vlerësuar si rrethana renduese pasi që i pandehuri edhe pse kishte shfrytëzuar fillimisht një here të drejtën për të votuar si votues me kushte ai serishtë shfrytëzon edhe të drejtën e tij për të votuar si votues i rregullt gjë që kjo konsiston në inkriminim të veprimit të tij.

Si rrethana lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale të kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, e që nga fakti se vepra penale është kryer në vitin 2013 çka rezulton se ka kaluar një kohë e gjatë që nga kryerja e kësaj vepre dhe se kjo vepër nuk rezulton se kishte pasoja të mëdha ngase nuk është dëmtuar procesi zgjedhor përkatësisht nuk ka ndryshim të rezultatit si pasojë e veprimit inkriminues të të pandehurit, ndërsa për veç kësaj gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë e që nga deklarimi i tij me rastin e pranimit të fajësisë rezulton se ai edhe vetë deklaroi se e ndien veten fajtor ky deklarim i tillë i të pandehurit, për gjykatën shpreh një pendim të thellë të tij për veprën penale, nga ana tjetër për veç pendimit që ka pasur i pandehuri me pranimin e fajësisë gjykata e ka vlerësuar edhe faktin se ai në seance ka premtuar në të ardhmen se nuk do të përsëris veprime inkriminuese, si rrethana tjetër lehtësuese ka gjetur se në të dhënat e shkresës së lëndës nuk rezulton se ky i pandehur të jete dënuar ndonjë here për ndonjë vepër penale e për më tepër edhe në aktakuzë theksohet se ndaj tij nuk zhvillohet as procedurë penale, prandaj gjykata vlerëson se bazuar në këto rrethana ky i pandehur kishte rënë ndesh me ligjin vetëm me rastin konkret ku e ka pranuar fajësinë.

Nga gjitha këto gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të pandehurit pasi që për gjykatën në rrethana të tilla mjafton se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit do të ndalojë kryerësin që të mos kryej vepra penale në të ardhmen e që ky është edhe qëllimi i dënimit me kusht.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur vetëm për paushallin gjyqësor ashtu që duke u bazuar në ndërlíkueshmërinë e çështjes penale të pandehurit e ka detyruar që të paguaj shumën prej 20 euro, me që gjykatës i mungonin të dhëna tjera sipas listës definitive të shpenzimeve të procedurës, pasi që të sigurohen këto të dhëna gjykata do të vendose me aktvendim të veçantë.

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike nuk i ishte parashtruar gjykatës, prandaj edhe gjykata vetëm ka konstatuar se nuk kishte kërkesë pasurore-juridike.



Andaj gjykata duke u bazuar me neni 248 dhe 326 e lidhur me nenin 365,450, e 463 te KPPK-ës nga arsyjeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Krimeve te Renda
P.nr.119/15 dt.27.01.2017

Procesmbajtësja :
Xhemile Babatinci



Kryetari i trupit gjykues
Burim Ademi



Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kane te drejte ne ankese ne afat prej 15 ditëve ne gjykatën e Apelit ne Prishtine- Departamenti i Krimeve te Rënda e nëpërmes kësaj gjykate.

